

ALBANSKA
SHQIP

MODERNIZONI SUEDINË

**MANIFESTI I ZGJEDHJEVE
I PARTISË SË MJEDISIT
- E ARDHMJA ËSHTË KËTU**

Manifesti i zgjedhjeve 2010 i Partisë së mjedisit – të gjelbërit. Për një kalim në të gjelbër që jep punë të reja, një politikë të nevojshme dhe solidaritet global.

miljöpartiet de gröna



E ARDHMJA ËSHTË KËTU

Zgjedhjet që bëjmë sot formojnë jetën të cilën do ta jetojmë në të ardhmen. Investimet që i bëjmë sot krijojnë shoqërinë e së nesërme. Ekzistojnë njohuritë të cilat kërkohen, për të krijuar një shoqëri të qëndrueshme. Këtu duhet bërë një ndryshim.

Partia e mjedisit del në zgjedhje me një politikë për një ndryshim të gjelbër që krijon vende të lira pune, një rritje të sigurisë dhe një Suedi më të fortë. Ne dëshirojmë të krijojmë një shoqëri afatgjatë dhe të qëndrueshme, e cila mund të përballet me sfidat e të ardhmes.

Partia e mjedisit dëshiron të investoj me të madhe në kalimin e gjelbër të të gjithë shoqërisë - një Green New Deal. Ne dëshirojmë ta bëjmë më thjeshtë për njerëzit që të bëjnë zgjedhjen e qëndrueshme në jetën e përditshme. Hekurudhat, energjia e ripërtitur, tramvajet, korsitë e biçikletave si dhe qytetet me energji moderne, janë ardhmëria jonë. Ne të gjelbërit dëshirojmë të bëjmë investimet e nevojshme. Ato, jo vetëm që janë të leverdishme - ato japin më shumë vende të lira pune.

Ne dëshirojmë të modernizo-

jmë Suedinë. Ne kemi nevojë për investime në shkollim, hulumtim, veprimtari biznesi dhe ndërmarrje. Do të bëhet më lehtë për njerëzit për të realizuar idetë e tyre dhe të guxojnë ta marrin hapin, nga roli i të punësuarit në ndërmarrje të veten.

Ne dëshirojmë të lëmë shoqërinë, blej dhe hedh gjërat. Duhet të jetë e leverdishme të riparosh kur të prishet diçka. Ne dëshirojmë të zbresim TVSh-n e shërbimeve, për të inkurajuar një konsumim të përshtatur mjedisit dhe njëkohësisht të krijojmë vende të lira pune. Shumë vende të lira pune, do të krijohen po ashtu, duke investuar në mirëqenien dhe në sektorin publik.

Ne të gjelbërit, në mënyrë konsekuente, jemi në anën e natyrës kur ajo kërcënohet nga interesat afatshkurta. Angazhimi ynë ndjeket nga një dashuri për natyrën, nga solidariteti i

fortë me njerëzit, të cilët jetojnë sot edhe me gjeneratat e ardhshme. Politika jonë synon një botë solidarizimi. Prandaj ne punojmë për paqe, të drejta të njeriut dhe çarmatim global.

Politika jonë është liridashëse. Ne dëshirojmë të krijojmë një shoqëri të barabartë, ku të gjithë njerëzit trajtohen njësoj. Për ne kjo është çështje themelore e lirisë. Shoqëria bëhet më e pasur dhe më dinamike, kur ne e pranojmë ekzistencën e dallimit në mënyrën e jetesës. Njerëzve duhet dhënë shans të ri për jetesë. Sistemet e sigurisë duhet të riparohen dhe duhet të jenë për të gjithë.

Së bashku me partnerët tanë të bashkëpunimit, Partia e mjedisit shkon në zgjedhjet, për të krijuar një qeveri të kuqe-gjelbër, pas zgjedhjeve parlamentare 2010.

INVESTO NË ZVOGËLIMIN E NDIKIMIT TË KLIMËS DHE NË PUNË TË REJA

1. SUEIDA DUHET TË MERR PJESËN E VET TË PËRGJEGJËSISË

Suedia duhet të merr pjesën e vet të përgjegjësive globale. Derdhjet në natyrë të gazrave që ndikojnë në klimën, duhet të zvogëlohen, në përputhje me rekomandimet e shkencëtarëve.

Rritja e taksave të mjedisit duhet ta bën më shtrenjtë përdorimin e lëndëve djegëse fosile.

2. DYFISHO KAPACITETIN E RRJETIT HEKURUDHOR

Një politikë moderne e mjedisit në tërë vendin kërkon investime të mëdha në rrjetin hekurudhor.

Kapaciteti për transport të udhëtarëve dhe të mallrave, duhet të dyfishohet. Ne dëshirojmë të ndërtojmë rrugë hekurudhore të shpejtësisë së lartë dhe të lidhim bashkë qytetet e mëdha suedeze Stockholm, Göteborg, Malmö, me Kopemhagen dhe Oslon. Ne, po ashtu, dëshirojmë të lidhim trungun e rrugëve hekurudhore

me binarët rajonal, ashtu që lidhjet rajonale të forcohen. Duhet të jetë më lirë të udhëtosh me tren se sa të ngasësh makinën ose të udhëtosh me aeroplan

3. ZGJERO TRAFIKUN KOLEKTIV

Për të krijuar më shumë qytete me klimë moderne, dëshirojmë të investojmë në zgjerimin e madh të trafikut kolektiv, si tramvaje, trena rajonal, metro dhe autobusë. Ne dëshirojmë të dyfishojmë pjesën e trafikut kolektiv, deri në vitin 2020. Nuk ka asnjë nevojë për ndërtimin e autostradave të reja. Transportet kolektive duhet të jenë të arritshme dhe të përdorshme, për njerëzit me funksione të zvogëluara.

4. KARBURANT TË RI PËR MAKINË

Shumë njerëz në Suedi janë të varur nga makina. Lëndët djegëse fosile duhet nxjerrë në treg, si për shkaqe të mjedisit ashtu edhe për shkaqe të kostos. Prandaj duhet dhënë mundësia të gjithë njerëzve të mbushin makinën me karburant të ripërtritur. Duhet të jetë më lirë të ngasësh me karburant të ripërtritur se sa me benzinë. Prodhimi i brendshëm dhe shpërndarja e karburantit të ripërtritur, duhet favorizuar. Duhet të jetë e mundur të mbushësh makinën me karburant të biogazit dhe të mbushësh bateritë e makinës elektrike, në tërë vendin.

5. PRODHO VET ELEKTRICITETIN TËND

Ne dëshirojmë ta bëjmë të leverdishme të prodhosh vet elektricitetin tënd. Më shumë

njerëz dëshirojnë të investojnë në energjinë e ripërtritit dhe të kontribuojnë që të zvogëlohet ndikimin tënd në klimën. Kjo domethënë se më shumë prodhues të jenë në gjendje të livrojnë elektricitet të ripërtritit në rrjetin elektrik. Ne dëshirojmë të aplikojmë një sistem me çmim fiks për elektricitetin e ripërtritit, si dhe të jetë e mundur matja neto tek prodhuesit e vegjël të elektricitetit.

6. INVESTO NË ENERGJI TË RIPËRTRITUR DHE NË EFIKASITET TË ENERGJISË

Ne dëshirojmë të zëvendësojmë energjinë bërthamore dhe karburantin e lëndëve djegëse fosile me energji të erës, biokarburant, energji nga dallgët, energji diellore dhe me efikasitet të energjisë. Ne dëshirojmë të investojmë në rikonstruktime të cilat të shpien në zvogëlimin e konsumimit të energjisë. Me këtë zvogëlohet kostoja e energjisë. Nxjerrja e uranimit duhet të ndalohet.

7. RREGULLO PROGRAMET MILIONËSHE

Ne dëshirojmë të aplikojmë një mbështetje të veçantë për investime, për të ndërtuar banesa të reja dhe për të rregulluar banesa të amortizuara dhe qendra të njësive të qyteteve, para së gjithash në lagje. Investimet duhet të shpien në mjedise më të mirë banimi dhe zvogëlim të konsumimit të energjisë.

8. MË SHUMË MALLRA NË TRENA DHE TRAGETE

Për të rritur sigurinë në trafik në rrugët tona dhe të zvogëlojmë derdhjet në natyrë, ne

dëshirojmë të aplikojmë një taksë për transportet e rënda me kamion. Kjo e bën më të leverdishme transportin hekurudhor dhe atë detar, në vend të transportit me kamion.

9. MBROJE NATYRËN DHE SHUMËLLOJSHMËRINË BIOLOGJIKE

Livadhet dhe kullotat me lloje të pasura duhet mbrojtur dhe duhet forcuar mbrojtja e bregut të detit. Pyjet e çmuara natyrore duhet mbrojtur. Suedia nga aspekti afatgjatë duhet të strehoj llojet e katër shtazëve të mëdha grabitqare: ujkun, macen e egër (Lynx), ariun dhe çakallin (Gulo gulo). Përhapja e helmeve të mjedisit duhet të zvogëlohet, p.sh. duke ndaluar lëndët mbrojtëse ndaj flakës që përmbajnë brom dhe lëndë turbulluese për hormonet. Ne dëshirojmë të ruajmë dhe të rikrijojmë toka të lagështa dhe me ligj të mbrojmë ujërat nëntokësore që janë të rëndësishme për furnizimin tonë me ujë.

10. BUJQËSI DUKE PASUR PARASYSH SHTAZËT

Përdorimi i lëndëve për luftim të barërave të këqija dhe plehtrat kimike, duhet të zvogëlohet në minimum. Mbrojtja e shtazëve duhet të forcohet dhe ne dëshirojmë të ndalojmë prodhimin e gëzofit nga lëkura e shtazëve. Tokat e mira duhet të ruhen. Ne dëshirojmë ta bëjmë të leverdishme të merremi me një bujqësi ekologjike të qëndrueshme. Suedia duhet të jetë prijëse në industrinë e gjelbër, si ekoturizmin, prodhimtarinë e ushqimit në sasi të vogla. Ne dëshirojmë të mbrojmë tokën nga të lashtat me gjene të manipuluar.

PUNË TË REJA, SIPËRMARRËS DHE NDËRMARRJE TË VOGLA

11. ULJE TË TVSH-S PËR NDËRMARRJET E SHËRBIMEVE

Ne dëshirojmë që sektori i shërbimeve të rritet duke e ulur TVSh-n në shumë fusha. Atëherë bëhet më lirë të riparosh gjërat e prishura, me ngrënë në restorant, të shkosh te floktari dhe të riparosh biçikletën. Duhet të stimulohet konsumimi qëndrueshëm i shërbimeve dhe ne dëshirojmë të marrim hapin e parë gjatë periudhës së mandatit tonë.

12. TAKSA TË ULURA PËR NDËRMARRJET E VOGLA

Ne dëshirojmë të ulim tarifën e punëdhënësve për ndërmarrjet e vogla me dhjetë për qind. Ne dëshirojmë që ndërmarrësit vetëm (e përbërë nga një person) të kenë edhe më shumë zbritje për të punësuarin e parë, gjatë vitit të parë.

13. KAPITAL ME RREZIK PËR NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

Ne dëshirojmë të themelojmë një fond kombëtar me risk për t'u lehtësuar më shumë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të kenë mundësi të kenë mjete financiare të kapitalit me risk. Fondi duhet të financohet duke ndarë fitimin nga ndërmarrjet shtetërore.

14. NJË INDUSTRI NË CEPIN E PËRPARMË

Shumë ndërmarrës të ri kanë si forcë që i çon përpara, të marrin më shumë përgjegjësi etike, sociale dhe nga aspekti i mjedisit. Kjo kontribuon për një zhvillim të qëndrueshëm. Duhet nxitur një rrethanë të tillë. Ne dëshirojmë t'i rrisin subvencionet për inovacionet, zhvillim të prodhimeve dhe zhvillim të teknikave të mjedisit, në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ndërmarrjet shtetërore dhe ato komunale duhet të kontribuojnë në teknikën e re të mjedisit, energjisë së ripërtitur dhe të jetë një shembull i mirë kur bëhet fjalë për zvogëlim të ndikimit në klimën. Ndërmarrje me karakter social dhe kooperative, duhet të jenë një pjesë e politikës së gjelbër për ndërmarrjet. Ne punojmë për themelimin e më shumë ndërmarrjeve në fshat. Ne dëshirojmë në mënyrë aktive të punojmë për të shfrytëzuar dhe për të përmirësuar mundësitë, për të marrë në konsideratë aspektet sociale, etike dhe të mjedisit, kur të shpallet një tender publik.

15. PUNË DHE SHKOLLIM PËR TË RINJTË

Ne dëshirojmë të aplikojmë një trainee-program (zakonisht, të sapodiplomuarit bëjnë praktikë dhe teori) në sektorin e mirëqenies. Ka nevojë të investohet më shumë në shkollimet profesionale dhe në vende të lira për shëgert. Më shumë shkolla të larta duhet të ofrojnë praktikë në ndërmarrje dhe organe zyrtare, si një pjesë e programeve shkollore.

16. NJË JETË KULTURORE TË HAPUR DHE TË GJERË

Një jetë të gjallë dhe krijuese kulturore është një faktor i rëndësishëm i suksesit si për shëndetin, kualitetin e jetës dhe zhvillimit të shoqërisë. Ne dëshirojmë të investojmë në kulturë, ashtu që të gjithë, sidomos fëmijët dhe të rinjtë, të kenë mundësi të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme kulturore, si ushtrues edhe si spektator. Shkollat e kulturës duhet të forcohen. Kultura është një alternativ moderne për konsumim material.

NGRITE KUALITETIN BRENDA MIRËQENIES, INVESTO NË SHKOLLIMIN

17. ASKUSH NUK DUHET TË JETË PA SIGURIM

Të gjithë duhet të përfshihen nga sigurimet e sigurta dhe moderne shëndetësore. Ne dëshirojmë që sigurimi shëndetësor t'ju jepet njerëzve për atë kohë që ata janë të sëmurë dhe të hiqet afati i skajshëm i sigurimit shëndetësor. Përgjegjësia e shoqërisë për një rehabilitim efikas është me rëndësi të veçantë. Një sigurim i përgjithshëm ndaj papunësisë, duhet të vlen për të gjithë.

18. ORAR MË TË SHKURTËR PUNE

Ne dëshirojmë të ulim orarin normal të punës në 35 orë në javë, për t'ju dhënë njerëzve më shumë kohë dhe kualitet më të lartë jetese. Si hap të parë, ne dëshirojmë të aplikojmë një mbështetje për prindërit me fëmijë të vegjël, që të zvogëlojnë orarin e punës si dhe të aplikohet viti i lirë. Ne dëshirojmë të hapim mundësinë për moshat e ndryshueshme të pensionit dhe të krijojmë mundësi të mira që të zvogëlojmë orarin e punës kur je afër moshës së pensionit.

19. SHUMËLLOJSHMËRIA BRENDA SHKOLLËS

Fëmijët kanë të drejtë të kenë mjetet e nevojshme në shkollë e t'ju bartin ato me veti në jetën e tyre. Prindërit dhe fëmijët duhet të kenë mundësi të mira të ndikojnë në mësim dhe të mund zgjedhin një pedagogji që i për-

shtatet fëmijës. Të gjithë fëmijët duhet të shihen dhe të kenë kohë me të rriturit në shkollë dhe në parashkollore. Prandaj, kualiteti i parashkollores dhe i shkollës fillore suedeze, duhet të rritet. Ne kemin nevojë të rrisim dendësinë e mësuesve, të zvogëlojmë grupet e fëmijëve dhe të rrisim kohën e orarit të mësimin. Ne dëshirojmë të mbrojmë shumëllojshmërinë e shkollave, pedagogjinë dhe drejtimet e shkollimit. Ne dëshirojmë të forcojmë demokracinë e nxënësit dhe të investojmë në kujdesin shëndetësor të nxënësve.

20. LË FËMIJËT TË JENË FËMIJË

Një fëmijëri e sigurt plotë lojërash duhet të jetë një e drejtë e të gjithë njerëzve. Një shoqëri e mirë për fëmijët është një shoqëri e mirë për të gjithë. Ne dëshirojmë të forcojmë të drejtat e fëmijës dhe të inkorporohet konventa e fëmijëve në ligjin suedez.

21. KUJDES PARANDALUES

Një mënyrë e punës, nxitëse dhe parandaluese për shëndetin, duhet të përshkojë gjithë kujdesin dhe përkujdesjen. Kujdesi duhet të jetë i barabartë dhe afër qytetarit. Ky duhet të karakterizohet nga puna në ekip me aftësi të gjera shëndetësore dhe psikosociale. Ka nevojë për investime të veçanta, për të zvogëluar mosshëndetin psikik dhe të përmirësojë kujdesin ndaj

të moshuarve. Për të zvogëluar përdorimin e gabuar të ilaçeve, duhet të ashpërsohet kontrolli dhe mbikëqyrja.

22. USHQIMI I MIRË

Ne dëshirojmë të aplikojmë një ngritje të kualitetit ashtu që ushqimi të jetë më i mirë në shkollë, kujdesin për të moshuarit dhe spitale, në vend të ushqimit të ngrohur që transportohet nga larg. Lëndët e para ekologjike dhe ushqim i prodhuar në afërsi, duhet të kërkohet kur shpallen tenderët. Prandaj ligji për tenderët publik, duhet të rishikohet, ashtu që të jetë e lejuar nxitja e blerjes lokale. Një ushqim i mirë dhe ushqyes si duhet është një pjesë e natyrshme e mirëqenies.

23. NJË SHKOLLË E LARTË E FORGUAR DHE MJETE STUDIMORE MË TË LARTA

Shkollimi është gjë qendrore e një shoqërie moderne. Kualiteti i shkollës së lartë duhet ngritur, që mësuesit t'ju kushtojnë më shumë kohë studentëve dhe përqendrim më të madh në pedagogji të mirë. Ne dëshirojmë t'ju ofrojmë njerëzve shanse të reja në jetë dhe t'ju lehtësojmë mundësinë për të studiuar gjatë të gjitha fazave të jetës. Prandaj, ne dëshirojmë të rrisim shtesën për studime dhe të përmirësojmë rrjetin social të studentëve. Bashkëpunimi në mes universitetit/shkollës së lartë dhe ekonomisë, të forcohet.

NJË SHOQËRI E BARABARTË RRITË LIRINË

24. BARAZIA NË FAMILJE DHE NË ORGANE DREJTUESE

Të dy prindërit kanë të drejtë të qëndrojnë në shtëpi me fëmijët e tyre dhe fëmija ka të drejtë në të dy prindërit. Ne dëshirojmë që sigurimi prindëror të ndahet në tri pjesë, ku secili nga prindërit të ketë pjesën e vet të sigurimit dhe mund të zgjedh një të tretën sipas dëshirës. Kjo rritë mundësinë e një barazie në mes prindërve. Ne dëshirojmë të aplikojmë një ligj për të vënë kuota për ndërmarrjet e bursës dhe organet drejtuese të ndërmarrjeve publike.

25. QETËSIA E GRUAS ËSHTË LIRI

Ne dëshirojmë të kemi resurse më të mëdha për punën e kujdestarive të grave, për qetësi të grave. Drejtësia duhet të të pret në mënyrë profesionale dhe me respekt. Legjislacioni mbi përdhunimin duhet të ashpërsohet, për të garantuar integritetin seksual. Fëmijët të cilët kanë përjetuar dhunë në shtëpi, duhet të konsiderohen si viktima

të krimit. Ata të cilët dënohen për keqtrajtim/rrahje, duhet të detyrohen t'u nënshtrohen një trajtimi. Edhe dhuna ndaj burrave si dhe ndaj dhunës në një marrëdhënie të të njëjtës gjini, duhet t'i kushtohet vëmendje. Më shumë resurse kërkohet për të luftuar prostitucionin dhe tregtinë me qenie njerëzore.

26. TË DREJTAT E NJËJTA PËR TË GJITHË

Legjislacioni kundër diskriminimit duhet të ashpërsohet. Ne dëshirojmë të nxisim të drejtat e barabarta të ndërmarrjet dhe organet zyrtare. Ne dëshirojmë të vazhdojmë punën për të drejtat e HBT-personave (personat homoseksual, biseksual dhe transpersonat). Puna kundër krimit të urrejtjes, të intensifikohet. Të gjithë njerëzit duhet të kenë mundësi për pjesëmarrje të plotë. Ne dëshirojmë që mosarritshmëria, në ligj duhet të klasifikohet si diskriminim i personave me aftësi të kufizuara.

27. TË MËSOSH ME GJUHËN AMTARE

Një nga mënyrat më efikase për të përmirësuar rezultatin e studimeve kur një fëmijë ka tjetër gjuhë amtare nga suedishtja, është që të investohet më shumë në mësimin e gjuhës amtare. Ne dëshirojmë të zgjerojmë të drejtën e mësimit të gjuhës amtare, gjatë gjithë kohës në shkollën fillore. Ne, po ashtu, dëshirojmë të shtojmë mësimin e më shumë lëndëve në gjuhën amtare.

28. SHKOLLIM DHE PUNË PËR TË SAPOARDHURIT

Të sapoardhurit duhet të kenë mundësi ta mësojnë gjuhën suedishte më shpejtë,

vlerësimin ose kompletimin e shkollimit, për të gjetur pune. Ne dëshirojmë që studimi i suedishtes të kombinohet me praktikë. Ne dëshirojmë të rrisim kualitetin e suedishtes si gjuhë të dytë. Ne dëshirojmë që universiteti dhe shkolla e lartë të ofrojnë kurse të suedishtes për ata që vijnë në Suedi dhe kanë shkollim akademik.

29. MBROJE TË DREJTËN E JETËS PRIVATE

Rreth e përqark në shoqëri kufizohet e drejta e njerëzve për një jetë private. Ne dëshirojmë të ashpërsojmë rregullat për dhënien e lejes së mbikëqyrjes me kamerë ashtu që në veçanti duhet pasur parasysh integritetin e individit. Shteti nuk duhet të ketë mundësi të regjistroj gjithë trafikun e internetit të përdoruesit. Ne dëshirojmë të heqim FRA-ligjin.

30. NJË INTERNET PA BREN- GA DHE NJË E DREJTË E BALANCUAR E AUTORIT

Ne dëshirojmë të mbrojmë mbrojtjen ligjore dhe integritetin në rrjet, duke e ndryshuar IPRED-ligjin. Ne dëshirojmë të modernizojmë të drejtën e autorit dhe mos ta quajmë krim shpërndarjen e skedave kompjuterike për përdorim privat. Neutraliteti i rrjetit është një princip i rëndësishëm i cili duhet mbrojtur.

NJË BOTË E DREJTË DHE E QËNDRUESHME ËSHTË E MUNDUR

31. NJË POLITIKË GLOBALE E KLIMËS

Derdhjet globale të gazrave që ndikojnë në natyrën, duhet të zvogëlohen. Ne dëshirojmë të punojmë nga aspekti global që të heqim të gjitha subvencionet për thëngjillin, naftën dhe energjinë bërthamore. Ne dëshirojmë të aplikojmë taksa mjedisi për lëndët djegëse fosile, në komunikacionin ndërkombëtar të aviacionit dhe atij detar, për të paguar kontributet për klimën në viset e varfra. Mbështetja ndërkombëtare për masat e klimës në viset e zhvilluara duhet të rritet.

32. TË LUFTOSH VARFËRINË

Ne dëshirojmë të punojmë për një tregti të drejtë e cila më shumë i merr parasysh nevojat e viseve të varfra. Niveli i ndihmës së Suedisë duhet të jetë, më e pakta një përqind e BNI-s (prodhimit të përgjithshëm kombëtar). Suedia duhet të punoj kundër dukurisë që viset e varfra të futen në kurthin e borxhit dhe për të mos legjitimuar borxhet, ato duhet të shlyhen. Lufta kundër varfërisë duhet të jetë politika qendrore e politikës së jashtme, e tregtisë dhe e politikës së ndihmës.

33. HEQJA E EKSPORTIT TË ARMËVE

Ne dëshirojmë të heqim eksportin e armëve. Një hap i parë është të ashpësojmë rregullat e eksportit të armëve suedeze. Është e papranueshme që armët suedeze të eksportohen vendeve të cilat i shkelin të drejtat e njeriut. Ne ju themi jo investimeve disa miliardësh, për një version më të përsosur të avionit JAS. Suedia duhet të qëndroj jashtë Natos. Përpjekjet për të arritur paqe në botë duhet të rriten. Përveç kësaj, ne dëshirojmë të ndalojmë prodhimin në Suedi të minave dhe bombave cluster (qindra bomba të vogla brenda një bombe të madhe).

34. STOP PESHKIMIT TË EGËR NË DETET TONA

Të gjitha subvencionet të cilat kontribuojnë në peshkimin e pafund (që të shpie në zhdukjen e një lloji të peshkut), duhet hequr. Merluci dhe llojet e tjera të peshqve në detet tona, duhet të mbrohen nga peshkimi i tyre, nëse lloji i tyre është brenda kufijve të sigurt. Masa të rrepta të merren ndaj peshkimit ilegal. Ne, po ashtu, duhet të rishikojmë politikën tregtare të Suedisë, ashtu që të zvogëlohet peshkimi i egër edhe në detet tjera të botës.

35. RESPEKT PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE POLITIKËN PËR REFUGJATË

Ne dëshirojmë të krijojmë më shumë rrugë të ligjshme të migrimit në BE. Ka nevojë për një politikë më njerëzore për refugjatët. Ka pasur, për një kohë të gjatë, mangësi në procesin suedez të migracionit, prandaj ne dëshirojmë të aplikojmë një amnisti, për ata pa dokumente përkatëse. E mira e fëmijës duhet të jetë në qendër të vëmendjes, në të gjitha fazat e vlerësimit të një lënde të refugjatit. Ata të cilët janë pa dokumentet përkatëse, duhet të kenë të drejtë të mjekohen dhe të shkojnë në shkollë.

36. JO UME

Ne dëshirojmë që Suedia ta mbaj edhe më tutje valutën e vet dhe të mos futet në UME (unionin monetar evropian). BE duhet të jetë më demokratike dhe më pak e centralizuar. BE nuk duhet të ketë një forcë të përbashkët mbrojtje.

VOTO MË 19 SHTATOR PËR NJË SUEDI TË GJELBËR, NJERËZORE DHE MODERNE

Lexo më shumë në www.mp.se

Bëhu anëtar përmes sms.
Dërgo tekstin "mpmedl ååååmmddxxx"
(mpmedl viti, muaji, dita, katër shifrat e fundit të
numrit personal) në numrin e telefonit 72456.
Kostoja 50:- + tarifa e trafikut.

miljöpartiet de gröna

